



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 534/Prot.  
3

Tiranë, më 30 / 6 / 2016

V E N D I M

Nr. 38, datë 30 / 6 / 2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015, datë 30/04/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", të procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "Telda Shop - 2015" Sh.p.k, Tiranë.

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit nr. 119, datë 09/05/2016 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "Telda Shop - 2015" Sh.p.k (Nipt L51523005E), me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit i Ligjit Nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij.

Kontrolluesi "Telda Shop - 2015" Sh.p.k ushtron aktivitet tregtar në fushën e shitjeve direkte të produkteve të bukurisë dhe në këtë kuadër përpunon të dhëna personale kryesisht për kategorinë e subjekteve të të dhënave "klientë" por edhe për "punonjësit". Kontrolluesi ka krijuar një bazë të dhënash në formatin Excel me të dhëna personale të klientëve të interesuar për produktet e tij që përmban: emër, mbiemër, adresë, numër telefoni. Referuar deklaratave të përfaqësuesit të kontrolluesit, përpunohen vetëm të dhënat e personave që kanë shfaqur interes duke kontaktuar me telefon pas reklamave në televizione.

1. Zyra e Komisionerit konstatoi se kontrolluesi "Telda Shop - 2015" Sh.p.k gjatë ushtrimit të aktivitetit tregtar realizon marketing të drejtpërdrejtë ndaj subjekteve të të dhënave (klientë) nëpërmjet kontaktit telefonik. Kontrolluesi nuk është në gjendje që të provojë marrjen e pëlqimit të klientëve për përpunimin dhe administrimin e të dhënave të tyre, sipas nenit 3 pika 24 të ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, duke vepruar në kundërshtim me nenin 6 pika 1/a të këtij ligji.

Zyra e Komisionerit vlerëson se ekzistenca e pëlqimit të klientëve është e vetmja mundësi ligjore e kontrolluesit, referuar nenit 6 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, për të legjitimuar përpunimin e të dhënave personale. Pëlqimi, në bazë të nenit 3 pika 24 të Ligjit, "duhet të jetë në formën e një deklarate me shkrim, i dhënë shprehimisht me vullnet të plotë e të lirë dhe duke qenë në dijeni të plotë për arsyen pse të dhënat do të përpunohen, çka nënkupton që subjekti i të dhënave pranon që të

*përpunohen të dhënat e tij*". Për sa kohë kontrolluesi nuk ka mundur të provojë ekzistencën e pëlqimit, Zyra e Komisionerit vlerëson se përpunimi i të dhënave është i paligjshëm, duke cënuar edhe "Parimin e ligjshmërisë së përpunimit", sanksionuar në nenin 5/1/a të Ligjit.

2. Në kuadër të zbatimit të detyrimit për informim, Neni 18 i Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, Zyra e Komisionerit konstatoi se kontrolluesi nuk i informon subjektet e të dhënave personale, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë. Në faqen e kontrolluesit <http://teldashop.com/> nuk janë të parashikuara "*politikat e privatësisë*".

Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë.

Informimi mund të bëhet nëpërmjet faqes zyrtare (politikat e privatësisë), në momentin e kontaktimit të klientit nëpërmjet operatorit të shërbimit telefonik, ose në momentin e dorëzimit të produktit nëpërmjet gjenerimit të një informacioni informues në kuponin tatimor/ose një format bashkëlidhur. Në çdo rast është e nevojshme që informimi i klientit të jetë lehtësisht i dukshëm dhe i provueshëm.

3. Kontrolluesi "*Telda Shop - 2015*" ka kontraktuar shoqërinë "*Ulysses Enterprises sh.p.k*" (*FedEx*) (në cilësinë e përpunuesit) me qëllim kryerjen e dërgesave postare të produkteve të porositura nga klientët e kontrolluesit. Për realizimin e qëllimit të kontratës së transportit, kontrolluesi vendos në dispozicion të përpunuesit, disa të dhëna të klientëve (emër, mbiemër, adresë dhe numër telefoni).

Pas analizimit të kontratës rezultoi se në të nuk janë parashikuar detyrimet përkatëse të palëve lidhur me mënyrën e përpunimit, garantimin e sigurisë së të dhënave personale, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj, në kundërshtim me nenin 20 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit e vlerëson si shumë të rëndësishëm parashikimin e këtyre detyrimeve kontraktore në kuadër të garantimit të sigurisë së të dhënave personale, të drejtave të klientëve (subjekte të të dhënave) dhe përcaktimit të përgjegjësisive përkatëse të palëve në rast shkeljesh të mundshme me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë dhe sensibilizimit të tyre mbi rëndësinë e mbrojtjes së të dhënave. Kjo kontratë përbën një garanci më shumë për subjektet e të dhënave.

4. Nga verifikimi paraprak i kryer në regjistrin elektronik të KDIMDP-së dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit si edhe nga hetimi administrativ i ushtruar rezultoi se kontrolluesi nuk e kishte përbushur detyrimin për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.

Në paragrafin 1, të nenit 21 të ligjit, parashikohet: "*Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë*".

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për njoftim është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep ligji.

Megjithatë, Zyra e Komisionerit vlerëson faktin që kontrolluesi reagoi në mënyrë të menjëhershme, në drejtim të plotësisimit të këtij detyrimi duke plotësuar formularin e njoftimit për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës.

5. Zyra e Komisionerit konstatoi se kontrolluesi *“Telda Shop - 2015” Sh.p.k* nuk kishte hartuar një *“Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”* në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave të klientëve dhe punonjësve, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve etj, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar.

Hartimi i rregullores është i rëndësishëm për kontrolluesin pasi përbën bazën e referimit për çdo përpunim të të dhënave, për çdo punonjës, dhe përcakton standartet ligjore për garantimin e një përpunimi të ligjshëm dhe të sigurtë të të dhënave personale. Rregullorja duhet të jetë gjithëpërfshirëse (të përfshijë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale për çdo kategori subjektësh të të dhënave).

Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverbali i konstatimit, si dhe në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 93-96 të ligjit nr. 44/2015, datë 30/04/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, në datë 21/06/2016 është mbajtur seanca dëgjimore me përfaqësuesin e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar.

Kontrolluesi gjatë seancës dëgjimore ka depozituar disa dokumente dhe prova në kuadër të realizimit të problematikave dhe shkeljeve të konstatuara në procesverbalin e hetimit administrativ:

- ✓ Autorizim i përfaqësuesit shoqëruar nga fotokopja e kartës së identitetit;
- ✓ Pretendime mbi realizimin e detyrimeve ligjore;
- ✓ *“Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*;
- ✓ *“Deklaratë specifike, e dhënë me vullnet të lirë nga subjekti i të dhënave personale për përpunimin e të dhënave të tij”* ku parashikohet edhe informimi;
- ✓ Aneks i marrëveshjes me përpunuesin, shoqërinë *“Ulysses Enterprises sh.p.k”*;
- ✓ Fatura tatimore për shitje produktësh.

Në tërësi kontrolluesi nuk i ka kundërshtuar konstatimet e Komisionerit, ka sjellë dokumenta për të provuar realizimin e detyrimeve ligjore dhe ka deklaruar që mangësitë kanë ardhur si pasojë e mosnjohjes së ligjit. Gjithashtu, ka pretenduar se kontrolluesi ka vetëm një punonjës dhe do të mbyllet në momentin e shiitjes së produkteve që kanë mbetur. Zyra e Komisionerit vlerëson se këto pretendime nuk përbëjnë shkak për mospërbushjen e detyrimeve ligjore dhe përjashtimin nga përgjegjësia.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39/1 shkronjat *“a”, “b”, “ç”, “d” dhe “dh”*, të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 *“Për*

*Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- Kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II "Përpunimi i të dhënave personale", dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- Kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk zbatojnë detyrimet e përcaktuara në nenin 20 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- Kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me gjobë në vlerën 10 000 deri në 500 000 lekë;
- Kontrolluesit ose përpunuesit që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë.

Kontrolluesi "*Telda Shop - 2015*" *Sh.p.k.* në formën ligjore të aktivitetit të tij tregtar është person juridik dhe sipas nenit 39/2 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze, ato lidhen me garantimin e përpunimit të ligjshëm të të dhënave, të drejtën e subjekteve të të dhënave për t'u informuar mbi përpunimin e të dhënave të tyre, detyrimin për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit dhe masat organizative dhe teknike të përshtatshme që duhet të merren për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale si dhe për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar. Gjithashtu, bazohet në bashkëpunimin gjatë ushtrimit të hetimit administrativ si dhe reagimin e kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

#### PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 18, 20, 27, 29, 30, 31, 39/1/b, 39/1/ç, 39/1/dh, 39/2, 40 dhe 41 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar,

#### V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit "*Telda Shop - 2015*" *Sh.p.k* me gjobë, në vlerën **20 000 (njëzetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit "*Telda Shop - 2015*" *Sh.p.k* me gjobë, në vlerën **20 000 (njëzetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 20 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.
3. Dënimin e kontrolluesit "*Telda Shop - 2015*" *Sh.p.k* me gjobë, në vlerën **20 000 (njëzetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.

4. Kontrolluesi **"Telda Shop - 2015" Sh.p.k** të fshijë të gjitha të dhënat e klientëve për të cilët nuk provohet marrja e pëlqimit sipas nenit 3 pika 24 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 *"Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale"* i ndryshuar.
5. Kontrolluesi **"Telda Shop - 2015" Sh.p.k** në rast të mbylljes së aktivitetit tregtar (sipas deklarimeve) dhe çregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit, të fshijë dhe shkatërrojë të gjitha të dhënat personale të klientëve që ka mbledhur në kuadër të realizimit të qëllimit të aktivitetit dhe të realizojë detyrimin ligjor për përditësimin e "Formularit të Njoftimit".
6. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot më datë 30.6 2016.

